



Planuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	31.12.2021	viti god year	1
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMST/KK	6449/2021		1/9



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.986/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti -anëtarë si dhe Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëse, bazuar në Aktgjykimin me numer A.nr.1022/2020 të datës 17.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative të pranuar me datën 01.12.2021 kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.46/2020 të datës 21.02.2020, të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banimi rruga "Haxhi Hasani" nr. 5 në Drenas në çështjen juridike "kërkesën nga marrëdhënia e punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 30.12.2021 mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.46/2020 e datës 21.02.2020 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në Policinë e Kosovës, me datën 21.02.2020, ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 424/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër të protokollit 03/02-28/20 të datës 28.01.2020 të Komisionit për Ankesa në Policinë e Kosovës, i pranuar nga ankuesi me datë 28.01.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullore Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes e Ankesave, më datë 26.02.2020 ka dorëzuar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Policinë e Kosovës, ndërsa me datë 11.03.2020, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 29.07.2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës si dhe duke e udhëzuar se mund ti ndjek procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund ta filloj procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 17.11.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1022/2020, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke anuluar njoftimin e datës 12.05.2020 të KPSHMCK-se dhe ka obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.46/2020 të datës 21.02.2020.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe për vendosje meritorie ka administruar këto prova: Ankesa e datës 21.02.2020 me numër të protokollit 424/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimi Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 28.01.2020 me numër të protokollit 03/02-28; Ankesa me numër Reference 07/1-01SAP-P/10541 e datës 24.12.2019 drejtuar Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi me numër Reference 07/1-01SAP-P/10541 i datës 03.12.2019 për sistemin për kohë të pacaktuar; E-mali i datës 21.02.2020; E-mali i datës 20.02.2020; Vendimi me numër 05/12 i datës 05.02.2015; Titujt e vendeve të punës të plotësuar dhe ndryshuar në Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës e muajit shkurt 2016; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Sektorit të arkivës i datës 01.09.2015; Konkursi i datës 07.02.2017 me numër të protokollit 632/2017 për pozitën Udhëheqësi i Sektorit për Planifikim; Konkursi me numër të Referencës 07/1-01R/08/19 për plotësimin e vendeve të punës për pozitën "Zyrtar i Lartë Ligjor" për dy (2) vende të lira pune; Memorandumi zyrtar i datës 19.10.2018; Memorandumi zyrtar me numër Reference 07/1-2SA/12/2018 i datës 11.10.2018; Kërkesë drejtuar Drejtorisë së Personelit nga ana e ankuesit; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 26.02.2020 me numër të protokollit 512/2020; Përgjigja në ankesë e datës 11.03.2020 me numër të protokollit 662/2020; Vendimi me numër Reference 07/1-SAP-P/10541 i datës 04.12.2019 për sistemimin për kohë të pacaktuar; Kontrata e punës për kohë të pacaktuar me numër të Referencës: 07/01-01A/0680 e datës 07.08.2014; E-mali i datës 13.02.2020; E-mali i datës 21.02.2020; E-mali i datës 17.01.2020; Njoftimi i datës 12.05.2020 me numër të protokollit 838/2020; E-maili i datës 23.12.2021 me numër të protokollit 6297; E-maili i datës 19.02.2021; Vendimi me numër të protokollit 1127/2010 i datës 28.10.2010; E-mailin e datës 29.12.2021 me numër të protokollit 6397/2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar Aktgjykimin me numër A.nr. 1022/2020 të datës 17.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe pas analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit [redacted] është e pa bazuar, *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi sipas Kontratës së Punës së datës 07.08.2014, ka ushtruar detyrën e punës "Shef i Sektorit të Arkivit", në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, me pagë bazë e shprehur në vlerë prej 464.75 Euro, ndërsa me Vendimin me Nr. reference 07/1-01SAP-P/10541 të datës 03.12.2019, ankuesi është sistemuar për kohë të pacaktuar në pozitën e punës "Shef i sektorit të arkivit", në Drejtorinë e Personelit, me

pagë bazë të shprehur në vlerë monetare 423.85 Euro, dhe shtesa 25.00. Euro. I pakënaqur me këtë vendim ankuesi me datë 24.12.2019 parashtron ankesë në Komisionin e Ankesave të Policisë së Kosovës, më kërkesën që të rishqyrtohet Vendimi për sistemim të përkohshëm i datës 03.12.2019, ti përmirësohet koeficienti sipas pozitës së katalogut të punës aprovuar nga MAP me datën 05.02.2015 si dhe të realizohet e drejta e pagës në mënyre retroaktive për atë kohë sa është i dëmtuar ankuesi.

Komisioni i Ankesave i Policisë së Kosovës, me Vendimin me numër protokolli 03/02-28 të datës 28.01.2020 ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit dhe lëndën e ka rikthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek Drejtoria e Personelit të Policisë së Kosovës.

Drejtoria e Personelit me datë 21.02.2020, ka njoftuar ankuesin se në zbatim të Vendimit të Komisionit të Ankesave me datë 13.02.2021 kanë parashtruar kërkesë në Ministrinë e Administratës Publike që të aprovonë kërkesën që pozita „Shef i sektorit“ të ketë koeficientin e pagës së njëjtë me pozitën e njëjtë në institucionet tjera të shërbimit civil, duke shtuar se derisa sa nuk ka aprovim nga kjo Ministri përgjegjëse, Policia e Kosovës nuk mund të vendos lidhur me ndryshimin e koeficientit.

Bazuar në dispozitat e Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil përkatësisht nënin 3 paragrafi 1 ku është përcaktuar se: *1. E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil*, ndërsa nënin 9 paragrafi 1 i po këtij Ligji përcakton se: *Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kontratës së punës*, Kolegji ka konstatuar se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësi civil gëzon të drejtën e realizimit të pagës të përcaktuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës. Andaj, mbi këtë bazë ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesi e realizon pagën sipas kontratës së punës respektivisht Vendimit të datës 03.12.2019 për sistemim për kohë të pacaktuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon për harmonizim të koeficientit si të nëpunësve të nivelit qendror dhe kompensim retroaktiv, ka konstatuar që Policia e Kosovës respektivisht Drejtoria e Personelit e Policisë së Kosovës ka bërë përpjekje të nevojshëm për harmonizim të koeficienteve ku më datë 05.12.2018 kanë kërkuar nga Ministria e Administratës Publike që të bëhet klasifikimi i vendeve të punës për stafin civil në Policinë e Kosovës, ndërsa pas Vendimit me Nr.03/02-33 të datës 28/01/2020 të Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës më të cilin është aprovuar pjesërisht ankesa e ankuesit dhe lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek Drejtoria e Personelit, Drejtoria e Personelit e Policisë së Kosovës më datë 13.02.2020 ka dërguar kërkesë për harmonizim të koeficienteve për pozitën e shërbësve civil në Policinë e Kosovës, tek Ministria e Administratës Publike por nuk ka marrë përgjigje lidhur me këtë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Policia e Kosovës ka ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për harmonizim të koeficienteve siç përcaktohet me Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregulloren Nr. 33/20120 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, pasi që në bazë të dispozitave të këtij ligji dhe kësaj rregulloreje, përcaktohet që *“grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit*



përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat" neni 7 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, si rrjedhojë harmonizimi i koeficienteve bëhet nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa, në këtë kuptim Policia e Kosovës duhet të bëjë vetëm planifikimin për harmonizim të koeficienteve veprim të cilin e ka ndërmarrë me rastin e kërkesës së datës 05.12.018 të cilët kanë kërkuar nga Ministria e Administratës Publike, andaj mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit është i pabazuar, ngase ngritja e koeficientit nuk është në kompetencë të Policisë së Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

Lënda me numër A.nr. 986/2021

Ilire MEHMETI-SHAQIRI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Gjykatës Themelore ne Prishtine Departamenti për Çështje Administrative, Gjyqtares Vjollca Limani
- Drejtorit të Drejtorisë së Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së